



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 27 mars 2018, në mbledhjen e I-rë (parë - konstituive), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.35’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Fatlume Jaha, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fitim Haziri, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica dhe Floretë Zejnullahu

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Gëzim Namani, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Miratimi i rendit të ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, meqë është mbledhja e parë e këtij Komitetit në këtë mandat të Kuvendit të Komunës më lejoni që fillimisht t’ju uroj punë të mbarë duke shpresuar se do të kemi bashkëpunim të mirë mes vete për çështje të cilat do të trajtohen paraprakisht në këtë Komitet para se të njëjtat të diskutohen në Kuvend. Për kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij Komiteti sigurisht jeni në dijeni në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe dispozita tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi. Andaj pa humbur kohë mund të fillojmë me punë.

Konsideroj se thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë me kohë, mirëpo para se të vazhdojmë me këto pika sipas rendit të ditës, ju njoftoj se e kemi edhe një kërkesë të Kryetarit të Komunës për përfshirje në kuadër të rendit të ditës propozim vendim për caktimin e lokacionit - parcelave për ndërtimin e fushës sintetike të futbollit, kërkesë të cilën tani ju shpërndahet dhe ku mund të analizoni arsyeshmërinë e saj, por prezent është edhe Drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë i cili mund të jap sqarime shtesë më të detajuara rreth kësaj pike.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, theksoi, ju njoftoj se kësaj kërkesë ose këtij propozim vendimi i ka paraprirë një shkresë e drejtuar nga Federata e Futbollit të Kosovës-FFK në të cilën ndër të tjera thuhet; FFK përmes fondeve të veta FIFA Forward Programme, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit-MKRS, Komunave të cilat kanë Klube të Futbollit të cilat garojnë në Super Ligën e Kosovës, do të investoj në territorin e Komunave të tyre 12 fusha sintetike të futbollit me

përmasa 105 m me 68 m sipas standardeve të FIFA-së dhe UEFA-së, investim ky i cili do të bëhet në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit mes tri Institucioneve ku FFK do të investoj për secilën fushë nga 120,000.00 €, MKRS me nga 100,000.00 € dhe Komunitet me nga 30,000.00 €. Do të thotë se do të jetë një investim prej 250,000.00 € në total. Pas marrjes së kësaj shkrese ne jemi angazhuar për të gjetur një lokacion – parcelë për të ndërtuar një fushë të tillë dhe kemi arrit të gjejmë në Fshatin Dumosh ku janë dy parcela të cilat i plotësojnë kushtet, dhe kjo është bërë në procedurë pothuajse urgjente, andaj kërkojmë edhe nga ju si Komitet dhe nga Kuvendi i Komunës që të miratohet ky propozim vendim në mënyrë që të mos mbesim mbrapa sepse disa nga Komunitet tani më veç e kanë kaluar në Kuvend këtë çështje në mënyrë urgjente.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, do të thotë materialin përkatës e kemi para vetës të gjithë dhe mund ta shqyrtojmë nëse arrin të futet si pikë shtesë, në pikën 9, në kuadër të rendit të ditës dhe njëkohësisht t'i rekomandohet edhe Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

z.Avni Fetahu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së e përkrahi këtë kërkesë për hir të zhvillimit të sportit ku jemi në dijeni se Klubi i Futbollit "Llapi" është në Super Ligë, e që është një rast i mirë për tu zgjeruar në këtë aspekt dhe në të njëjtën kohë të kontribuojmë të gjithë në të mirë të sportit.

z.Fitim Haziri, theksoi, kam pyetje rreth lokacionit se ku saktësisht është. Pastaj a keni pas kontakte ose biseda paraprake me Klubin si dhe a ka mund të gjendet ndonjë lokacion më afër qytetit këtu ndokund.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, theksoi, lokacioni ose parcelat përkatëse janë përball shkollës përkatësisht prej këtu ku jemi, shkolla e Fshatit mbetet në anën e majtë, konkretisht ai vend njihet ndryshe si përball Kutleshve, ku është një rrugë e cila duhet pastaj të zhvendose pak sa. Kërkesa ka qenë që lokacioni të jetë mbi 3 hektar kurse në më afër qytetit nuk kemi mund të gjejmë, mirëpo lokacioni i propozuar ka qenë më i pranueshmi si për ne ashtu edhe për Klubin me të cilin kemi pas biseda paraprake rreth kësaj çështje. Kanë qenë në variante disa prona siç janë, prapa parkut të pishave, pastaj një në Fshatin Peran si dhe ajo në Fshatin Lupç i Poshtëm siç njihet në bugurdoll, por që asnjëra prej tyre nuk i ka plotësuar kushtet e kërkuara.

z.Fitim Haziri, theksoi, pas arsyetimeve të dhëna, edhe ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së nuk kemi diçka kundër kësaj dhe e mbështesim një kërkesë të tillë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne si Komitet japim vetëm rekomandime, andaj edhe Grupi i këshilltarëve të PDK-së e mbështetë propozimin për shqyrtimin e kësaj pike shtesë në kuadër të rendit të ditës, sepse jemi për mbështetje të sportit në Komunën tonë e në këtë rast të Klubit të Futbollit "Llapi". Sa i përket parcelave dhe projeksioneve të ndërtimit dhe infrastrukturës përcjellëse besoj që Ekzekutivi i Komunës në bashkëpunim me FFK-në do t'i përfundojë ato çështje me qëllim që ajo fushë ose ai stadion të përfundojë, të duket sa më mirë dhe ai Fshat të merr një pamje të mirë si dhe i njëjti të jetë në shërbim të Klubit "Llapi" dhe të qytetarëve. Konsideroj se lokacioni përkatës sigurisht që do të merr një pamje shumë më të mirë se si është aktualisht sepse është zonë e pazhvilluar dhe ka mbeturina në atë hapësirë. Pra ne e mbështesim këtë kërkesë dhe njëkohësisht i rekomandojmë që tani Kuvendit për shqyrtim e që besoj se edhe në Kuvend do të mbështetet nga shumica e këshilltarëve, sepse ndër të tjera është edhe investim ku rreth 95% është participim nga FFK dhe MKRS.

U konstatua se njëzëri u mbështet kjo kërkesë – propozim vendim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, tani vazhdojmë me rendin e propozuar të ditës. Nëse dëshiron dikush të marr fjalën urdhëroni, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe pikën shtesë.

Pas votimit u konstatua se njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës për këtë mbledhje duke përfshirë edhe pikën shtesë;

- **Propozim vendim për caktimin e lokacionit - parcelave për ndërtimin e fushës sintetike të futbollit**

1. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2017 në vitin 2018 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, fillimisht përshëndeti anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa duke iu dëshiruar punë të mbarë suksese dhe mirëkuptim, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, të hyrat vetanake të cila nuk kanë arritur të shpenzohen gjatë vitit paraprak, në këtë rast 2017, me automatizëm sipas ligjit për financat publike dhe ligjit të buxhetit, barten në vitin vijues, në këtë rast në vitin 2018. Projektet në të cilat barten këto mjete duhet të jenë të vitit 2017, andaj edhe projektet e cekura në specifikacion janë projekte të cilat kanë filluar në vitin 2017 kurse do të përfundojnë vitin 2018. Shuma e dedikuar për administratë komunale i përfshinë të gjitha Drejtoritë përveç Drejtorisë së Arsimit dhe asaj të Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale, ndërsa mjetet që janë të dy Drejtorive të cekura janë mjete të mbrojtura të cilat këto dy Drejtori i kanë realizuar në veprimtaritë e tyre siç është shembull, në shëndetësi participimi i qytetarëve për shërbimet të cilat ofrohen në QKMF-AMF, mjete të cilat me automatizëm barten në atë Drejtori sipas planifikimeve që kanë pasë për vitin 2017, e njëjta vlen edhe në Drejtorinë e Arsimit.

z.Fitim Haziri, theksoi, i nderuar Kryesues, këto pika të rendit të ditës janë dërguar para rreth 10 ditëve dhe i kemi analizuar, andaj nuk di sa ja vlen të diskutojmë ne sot për këto pika kur të njëjtat sërish do të diskutohen në mbledhjen e Kuvendit. pra këshilltarët e Kuvendit janë thirr për nesër që do të mbahet mbledhja e Kuvendit, kurse ne sot po diskutojmë për të njëjtat pika, prandaj a mundemi ne sot të ndryshojmë rendin e ditës, të heqim, të shtojmë apo të ndryshojmë ndonjë pikë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sqarim parafolësit, Komiteti për Politikë dhe Financa është organ rekomandues e jo vendimmarrës, ndërsa ne sot debatojmë rreth këtyre pikave dhe mund t'i rekomandojmë apo jo Kuvendit për shqyrtim dhe marrje të vendimit për këto pika të cilat natyrisht në Kuvend mund të votohen ose jo. Pra nëse ne me vota nuk i rekomandojmë Kuvendit këto pika, ato nuk shqyrtohen fare në Kuvend.

Sa i përket kësaj pike, në bazë të ligjit mjetet vetanake të Komunës nuk mund t'i merr askush sepse ato menaxhohen nga vetë Komuna edhe nëse mbeten suficid nga ndonjë projekt sepse nuk janë grand, mirëpo pse nuk janë realizuar projektet në vitin 2017 dhe pse nuk janë bërë pagesat është çështje tjetër e cila duhet të diskutohet. Nëse dëshironi t'i heqim debatet krejt në KPF ne vetëm mund të marrim një vendim me të cilin i rekomandojmë këtë rend dite me 9 pika Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

z.Fitim Haziri, shtroj pyetje, a do të vazhdoj edhe në të ardhmen të thirret mbledhje e KPF-së para mbledhjes së Kuvendit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sqarim parafolësit, mbledhjet e KPF-së ja po thuajse është procedurale, para çdo mbledhje KPF mban mbledhje dhe i rekomandon Kuvendit për pikat e rendit të propozuara, ose thënë ndryshe në një formë është thjeshtëzim i rendit të ditës për Kuvendin e

Komunës për pika të caktuara ku Grupet e këshilltarëve pajtohen ose jo për çështje të ndryshme. Pra për çështje rreth mbledhjeve të Kuvendit dhe Komiteteve është Kryesuesi i Kuvendit që duhet të jap sqarime, mirëpo unë vetëm dëshiroj t'i përgjigjem parafolësit. Tani më ne veç e miratua rendin e ditës për këtë mbledhje dhe jemi në pikën 1 të rendit të ditës. Pastaj ne morëm sqarimet e nevojshme prej dy Drejtorëve parafolës dhe mund të vazhdojmë të kërkojmë nga secili Drejtor sqarime të tilla për pikat përkatëse apo ndryshe mund të mos ndalemi fare në sqarime të tilla por të njëjtat t'i lëm për Kuvend. Natyrisht që edhe unë në mandatin e kaluar kam qenë më i zëshmi në aspektin e kundërshtimit të praktikës që mos të futen pika shtesë duke u futë në KPF e pastaj në Kuvend një ditë para mbledhjes, mirëpo për këtë që patëm sot rreth zhvillimit të sportit nuk kam vërejtje dhe nuk e kundërshtoj, madje mendoj se duhet të kemi depolitizim të plotë kur kemi të bëjmë me një Klub të Futbollit siç është "Llapi" i cili është duke ecë përpara.

z.Fitim Haziri, theksoi, unë kam menduar që mbledhjet e KPF-së mbahen disa ditë para mbledhjeve të Kuvendit, dhe nuk e di se a rregullohet kjo çështje me ndonjë akt që mbledhjet e KPF-së të mbahen 1 ditë përpara mbledhjeve të Kuvendit. e them këtë sepse fjala bie, nëse ne shtojmë një pikë siç është rasti sot pastaj me siguri se do të ishte problem për këshilltarët tjerë të përgatiten për atë pikë.

znj.Fatlume Jaha, sqarim parafolësit, dita se kur mbahet mbledhja e KPF-së nuk është me rëndësi shumë por ajo që ka rëndësi është se materiali dërgohet me kohë dhe me atë material do të punojmë ne në dy mbledhjet, qoftë në KPF qoftë në Kuvend.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket futjes së pikave shtesë që anëtari Haziri e ceku, edhe unë jam kundër futjes së pikave me shtesë në rend të ditës në këtë formë, mirëpo kjo për ndërtimin e fushës së Futbollit përveç që ishte urgjente ishte edhe e arsyeshme dhe me interes të përgjithshëm andaj nuk mund ta bllokojmë sepse është një projekt me një investim 250,000.00 € pavarësisht kush do ta bënë implementimin e projektit, pra janë disa projekte ose vendime me urgjencë që ne edhe po deshëm nuk bënë t'i bllokojmë ngase tash së fundmi po ka luftë për thithje të investimeve kapitale sikurse që kemi rastin e Stadiumit Kombëtar i cili u zhvendos nga Prishtina në fusha të Drenasit, kurse për pika sipas tekeve, unë do të jem kundër.

z.Fitim Haziri, theksoi, serish dëshiroj të shtroj pyetje, a mundemi që mbledhjet e KPF-së t'i caktojmë më herët e jo një ditë para mbledhjes së Kuvendit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, është praktik e Komunave si vendosin t'i mbajnë këto mbledhje të KPF-së, Komuna e Podujevës gjithëherë ka mbajtur në këtë formë 1 dië para mbledhjes së Kuvendit.

z.Mehmet Gashi, theksoi, nga përvoja po flasë, jemi në dijeni se Komiteti për Politikë dhe Financa është trupa më e rëndësishme e Kuvendit, Komiteti i cili ndihmon punën e Kuvendit për çdo material i cili parashihet të shqyrtohet në Kuvend ku nga mbledhje e KPF-së i rekomandohet Kuvendit për miratimin, mos miratimin ose për plotësim ndryshime të një materiale e gjëra të ngjashme, mirëpo nuk do të thotë se ne i rekomandojmë dhe Kuvendi duhet patjetër t'i pranoj ato sepse Kuvendi është organ vendimmarrës, por rekomandimet e KPF-së zakonisht janë miratuar edhe në Kuvendin e Komunës.

Sa i përket propozim vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga 2017 në vitin 2018 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore, është një e drejtë ligjore e cila vjen si shkak se mjetet e arkëtuara gjatë muajit nëntor-dhjetor është e pamundshme të shpenzohen në atë vit andaj është paraparë mundësia që ato të barten në vitin tjetër në projekte të atij viti që janë arkëtuar, në këtë rast për projekte të vitit 2017. Kjo shumë e bartjes nuk është e madhe në krahasim me vitin e kaluar që ka qenë afër dy fish më e madhe se kjo. Çështjet tjera i arsyetoj edhe drejtori përkatës, mirëpo në material kam vërejtur dy gabime teknike të cilat është mirë të korrigjohen, dhe atë, në

faqen 1 të specifikacionit ku thuhet nga viti 2016 në vitin 2017 duhet të korrigojohet, nga viti 2017 në vitin 2018, si dhe aty ku thuhet 2016-2017 të duhet të jetë 2017-2018. Kështu pra ne sot mund të diskutojmë, të japim mendime, sugjerime etj, dhe në fund t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim me ato sugjerime, mendime etj.

Sa i përket thirrjes dhe caktimit të mbledhjeve të KPF-së, është në kompetencë të Kryesuesit se kur ai vendos të caktoj mbledhjet, natyrisht edhe me pajtimin e shumicës së anëtarëve të Komitetit, zakonisht edhe në të kaluarën mbledhjet e KPF-së janë mbajtur një ditë para mbledhjeve të Kuvendit, mirëpo nuk do të thotë që ato nuk mund të caktohen dhe mbahen disa ditë para mbledhjes së Kuvendit.

z.Rafet Lllashtica, theksoi, konsideroj se kjo formë e mbajtjes së mbledhjeve të KPF-së një ditë para mbledhjes së Kuvendit është më e logjikshme sepse dërgimi i materialeve të mbledhjeve dihet se duhet të dërgohet 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes për mbledhje të rregullta, kurse tri ditë para atyre të jashtëzakonshme, andaj nëse ne sot mbajmë mbledhje dhe nesër e dërgojmë materialin e rekomanduar për Kuvend e cila duhet të mbahet pas 3-4 dite, është problem sepse nuk ka kohë të mjaftueshëm pastaj të analizohen dhe përpunohet ai material nga ana e këshilltarëve, e që pastaj mbledhjet nuk do të mund të dalin ashtu siç duhet, kështu që afati 7 ditor i ka dhënë element mbledhjeve që ato të mbahen një ditë para mbledhjes së Kuvendit.

Materialet e propozuara janë të Ekzekutivit të Komunës, ne i shqyrtojmë dhe rekomandojmë se çka duhet bërë në Kuvend.

z.Fitim Haziri, theksoi, nëse ne sot bashkërisht fusim një pikë në rend të ditës dhe ajo pikë i rekomandohet Kuvendit, atëherë mendoj se është shumë kohë e shkurtër që ajo pikë të shqyrtohet dhe analizohet nga këshilltarët e Kuvendit të cilët do të marrin pjesë një ditë pas në mbledhje të Kuvendit.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, sa i përket kësaj çështje që parafolësi po e ngritë, nuk është që ka shumë shpesh pika shtesë siç ishte kjo që hyri sot, një gjë e tillë ndodh vetëm në raste urgjente për pika të jashtëzakonshme.

z.Fitim Haziri, theksoi, sa i përket kësaj pike, unë kam vërejtje sepse materiali i dërguar është shumë i vështirë të kuptohet sepse nuk shihet, nuk është i qartë për shkak të skanimit të dobët që është bërë.

z.Avni Fetahu, theksoi, jemi në dijeni se ligji e mundëson një bartje të tillë të mjeteve financiare ashtu siç u arsyetua edhe nga Drejtori i DBF dhe nga kolegët tjerë. Është fat i mirë që ato mjete nuk mund të humbin, pra t'i kthehen Qeverisë, por të njëjtat destinohen në projekte të cilat kanë mbet në gjysmë. Ne grupi i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim, dhe sigurisht që Drejtorët përkatës nesër në mbledhjen e Kuvendit do t'i arsyetojnë realizimin apo mos realizimin e projekteve përkatëse.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, meqë në këtë përbërje jemi një grup më i vogël i këshilltarëve, propozoj që do të ishte mirë që mos të shkojmë gjithëherë me praktikën e përfaqësuesve të grupeve por kushdo që ka diçka mund ta shpreh lirshëm në mënyrë që pak a shumë t'i japim një strukturim dhe të dihen qartë qëndrimet e subjekteve si dhe të jemi më racional, përndryshe në rast se flasin vetëm përfaqësuesit e Grupeve pastaj ne po dalim si të tepërt në këtë përbërje.

z.Fitim Haziri, theksoi, përveç vërejtjes që e ceka paraprakisht, ne si Grup i LVV-së do të jemi kundër kësaj pike. Nga kjo shumë e ndarë prej mbi 323,000.00 €, shëndetësia është me 10,000.00 € e që nuk jam në dijeni të plotë rreth gjendjes së shëndetësisë në Komunën e Podujevës, pastaj për arsim janë destinuar vetëm 12,000.00 €, dhe çështje të tjera të cilat na bëjnë të jemi kundër kësaj pike.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, e mbështesim që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, pastaj në Kuvend Grupi jonë nga radhët e PDK-së do t'i paraqet qëndrimet tona.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, konsideroj se parafolësi anëtar nga LVV-ja në këtë Komitet nuk ka informata dhe nuk e ka të qartë pse këto mjetet janë propozuar të barten në vitin 2018 në projekte konkrete sipas specifikacionit, gjë e cila pastaj mund të ndikoj që ai të jetë kundër për shkak të paqartësive që ka.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, theksoi, e ndjejë si obligim të jap edhe disa sqarime shtesë për parafolësin z.Fitim Haziri rreth kësaj pike. Të hyrat që realizohen zakonisht në muajin nëntor dhe dhjetor të cilat nuk mund të shfrytëzohen në atë vit fiskal, është e drejtë ligjore që automatikisht ato mjete të barten në vitin vijues, por duhet të përfillen dispozitat ligjore që kjo të bëhet me vendim të Kuvendit të Komunës në mënyrë që të ketë transparencë se ku do të destinohen ato mjetet. Obligim ligjor i parë është se ato mjetet duhet të barten në kontratat e pambuluara të vitit paraprak, dhe këtë e keni të sqaruar mirë në propozim vendimin përkatës se ku destinohen mjetet, duke veçuar mjetet të cilat barten në shëndetësi dhe arsim të cilat janë të hyra të mbrojtura të cilat janë realizuar nga vet ato dy Drejtori dhe të njëjtat duhet të barten po në ato dy Drejtori dhe nuk mund të barten në projekte të Drejtorive tjera. Pjesa tjetër që është propozuar të barten është kryesisht në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit për projekte të cilat janë lidhur kontrata por që nuk kanë mund të realizohen në vitin paraprak, kurse me këto mjete mbulohen ato kontrata dhe do të përfundojnë ato projekte, pra projektet janë të vitit 2017 dhe mjetet janë të vitit 2017. Po ashtu kemi mjetet në Drejtori tjera, siç është në Drejtorinë e Administratës, për inventarizimin e objektit të ri të Komunës, pastaj njëjtë është edhe për bartjen e të hyrave për subvencione dhe transfere ku kemi të bëjmë për projektin e serave, si dhe në projekte tjera të Drejtorive tjera sipas propozim vendimit dhe specifikacionit të bashkëngjitur.

Edhe njëherë po e përsërisë që këto janë mjetet të planifikuara për projekte të vitit 2017 por që janë realizuar në muajt e fundit e që nuk kanë mund të destinohen po në atë vit.

z.Fitim Haziri, theksoi, meqë ne disa nuk jemi profesionalist në këtë lëmi, kërkoj të jepen sqarime rreth kodeve sepse nuk kemi njohuri rreth tyre.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, theksoi, secili kod buxhetor e ka përshkrimin e vet, shembull, kodi i rrugës në Kërpimëh ku Ministria e Financave e ka përcaktuar 45936 që është një kod unik që nuk e ka asnjë projekt në Kosovë, pastaj 31230 është kod ekonomik me të cilin identifikohet si rrugë – ndërtim i rrugëve lokale, kod ky unik i cili vlen në tërë Kosovën për projekte të ndërtimit të rrugëve lokale. Pra shpresoj se u sqaruam shumë qartë rreth pyetjeve të ngritura.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, konsideroj se diskutimet rreth kësaj pike u mbyllën, u than të gjitha çështjet e nevojshme dhe njëkohësisht u bënë sqarimet e nevojshme nga ana e Drejtorit të Drejtorisë përkatëse, edhe pse ndoshta u diskutua dhe u dhanë sqarime dhe përgjigje jashtë kësaj pike, por meqë është mbledhja e parë nuk ka ndonjë problem dhe e lejova një gjë të tillë.

Pra e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës duke përfshirë edhe korrigjimin e gabimeve teknike që u ceken.

Me 7 vota për, 2 vota kundër, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim, me korrigjim të gabimit teknik, në faqen 1 të specifikacionit ku thuhet “.....nga viti 2016 në vitin 2017”, të korrigjohet “... nga viti 2017 në vitin 2018”.

2. Raporti Financiar për vitin fiskal 2017

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera shtoi, është një material i cili paraqet të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e bëra gjatë viti 2017, ku fillimisht figurojnë shpenzimet si total e pastaj jepen sqarime prej nga vijnë fondet-burimet e mjeteve financiare. Në fund është paraqitur edhe shuma totale e alokuar për shpenzim ku thuhet është një buxhet i shpenzuar prej 93.76%, pastaj janë të cekura shpenzimet sipas kategorive ekonomike, paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, subvencione, komunalit dhe ato kapitale, e që secila prej tyre e ka edhe burimin prej nga janë financuar, të cilat janë paraqitur edhe me grafikone. Mandej janë paraqitur edhe shpenzimet sipas Drejtorive, po ashtu janë edhe shpenzimet sipas kodeve ekonomike duke bërë një krahasim edhe me vitin e kaluar për të njëjtin kod, pastaj pagesat për investime kapitale sipas operatorëve ekonomik si dhe krejt në fund të raportit është një tabelë e të hyrave vetanake e që do të thoja se me të hyrat nuk qëndrojmë mirë sepse kemi vetëm 69% të të hyrave të planifikuara, edhe pse shumë herë kam bërë thirrje që të shlyhen borxhet nga ana e qytetarëve ngase ato mjetet sërish përmes investimeve ju kthehen qytetarëve ku për çdo vit jemi të detyruar që t’ju dërgojmë Ministrisë së Financave – Departamentit të tatimit në pronë projektet e realizuara nga të hyrat vetanke, madje edhe përmes fotove. Pra mund të themi se tatimi në pronë është një burim kryesor në të cilin duhet të mbështetet secila Komunë, por fatkeqësisht po e them se ende nuk kemi arrit të ngrisim nivelin e vetëdijes tek të gjithë qytetarët në mënyrë që të paguajnë atë obligim të vogël do ta quaja sepse mesatarja e tatimit në pronë në territorin e Komunës së Podujevës është rreth 25 € për objekte banimi, që i bie afërsisht me pagesën e rrjetit të internetit për një muaj nga një familje, por edhe përkundër kësaj ka persona të atillë që ende përdorin metoda dhe gjejnë mënyra për të mos paguar tatimin në pronë si një e hyrë kryesore në të cilën mbështetet Komuna për investime kapitale. Ju do të shihni tani edhe në vitin 2018 ku janë rreth 1 milion e gjysmë euro të parapara nga të hyrat e që sa do t’ia arrijmë të arkëtojmë mbetet të shihet, mirëpo barra kryesore mbetet tek ne, mirëpo edhe tek të gjithë përfaqësuesit e qytetarëve të cilët mund të na ndihmojnë sa i përket shlyerjes së borxheve nga ana e qytetarëve, gjë e cila do t’i kursente ata edhe nga dënimet dhe ndëshkimet ligjore që parashihen. Kur e them këtë e kam parasysh një pjesë të qytetarëve të cilët nuk kanë mundësi të paguajnë rregullisht për shkak të kushteve jo të mira ekonomike ndaj të cilëve zakonisht kemi pas konsideratë, mirëpo një pjesë e madhe kanë mundësi.

z.Avni Fetahu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, konsiderojmë se raporti në fjalë është mirë i punuar dhe i cili pasqyron të hyrat dhe shpenzimet për vitin 2017 si dhe në të njëjtën kohë jep mundësi për diskutim këshilltarëve të Kuvendit dhe një pjese të Drejtorëve të Drejtorive. Pra ne e përkrahim që t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

z.Fitim Haziri, theksoi, ne si Grup i LVV-së sa i përket këtij raporti financiar kemi disa vërejtje rreth disa pikave të cilat nesër do t’i bëjmë publike në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e mbështesim që kjo pikë t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

z.Mehmet Gashi, theksoi, e kam lexuar këtë raport, nuk kam diçka të shtoj përveç disa gabimeve teknike në material të cilat është mirë të korrigjohen, ato janë; në fillim të dokumentit dhe në faqe 11, ku figuron viti 2016 duhet të jetë viti 2017.

Me 7 vota për, 2 vota kundër, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim, me korrigjim të gabimit teknik, në faqen 2 të shpenzimet totale për periudhën janar – dhjetor 2017, në rreshtin ku figuron 2016 duhet të jetë 2017, si dhe në faqen 11 të dokumentit, në titull ku figuron viti 2016, duhet të jetë viti 2017.

3. Propozim vendimi për themelimin e komisionit vlerësues për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalës hyrëse rreth këtij propozim vendimi, ndër të tjera shtoi, sigurisht që jeni të informuar se pronat e Komunës jepen në shfrytëzim përmes komisionit përkatës i cili duhet themeluar nga Kuvendi i Komunës, siç kemi rastin tani. Gjithashtu dua t'ju njoftoj se nga takimet që kemi pasë me në një punëtori me Ministrinë e Administrimit të Pushteti Lokal-MAPL, ligji në fjalë është në fazën e plotësim ndryshimet ku parashihet që ky komision të zvogëlohet nga 7 në 5 anëtarë, çështje të cilën e kam ngreh si shqetësim se ne tani po themelojmë komisione prej 7 anëtarëve, por me siguri se MAPL do ta ketë parasysh këtë dhe do të bënë një zgjidhje, ose do të vazhdoj ky komision deri në fund të mandatit sepse ashtu ndërlidhet ose ta shohim si do ta rregulloj këtë çështje, kurse me ligjin e ri ai numër zvogëlohet, si të veprojmë ne pastaj, mirëpo ne duhet ta respektojmë ligjin në fuqi dhe të vazhdojmë me propozime sipas përbërjes që parashihet me ligj përkatësisht 3 anëtarë nga Ekzekutivi i Kuvendit, 3 anëtar nga Kuvendi dhe 1 anëtarë nga Shoqëria Civile.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, zyra për informim ka informuar Shoqërinë Civile, presim që deri nesër t'i dërgojnë të propozuarin e tyre.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne trupat e kuvendit siç është rasti i këtij komisioni i ngritim në bazë ligjit që është në fuqi, kurse çka miratohet pastaj ne do ta harmonizojmë varësisht si do të rregullohet nga Ministria. Mendoj që tani ne duhet të veprojmë ashtu siç parashihet me ligjin në fuqi e që janë 7 anëtarë në këtë komision. Rast të ngjashëm kemi pasë në mandatin e kaluar me rastin e Komiteteve obligative por që kemi vazhduar ashtu deri në fund të mandatit, kështu që nuk kam diçka tjetër në këtë mbledhje, e përkrahim ngritjen e këtij komisioni ndërsa për detaje tjera nesër i paraqesim në Kuvend.

z.Avni Fetahu, theksoi, konsideroj se ky komision është i rëndësishëm për dhënien e pronave të komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, kështu që e përkrahim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim me konstatim që emrat të paraqiten në mbledhjen e Kuvendit që do të mbahet nesër.

z.Fitim Haziri, theksoi, edhe ne e përkrahim themelimin e këtij komisioni dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim, kurse emrat e propozuar do t'i paraqesim nesër.

Njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim, me konstatim që emrat e anëtarëve të propozohen në mbledhjen e Kuvendit.

4. Propozim vendimi për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies të pronës së paluajtshme të Komunës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, edhe në këtë pikë kemi të bëjmë ngjashëm sikurse në komisionin paraprak me të vetmin ndryshim në përbërje e tij ku në bazë të ligjit parashihen të jenë 2 anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës, 2 anëtarë nga Kuvendi i Komunës dhe 1 anëtarë po ashtu nga Shoqëria Civile. Emrat sigurisht që edhe për këtë Komision do të paraqiten nesër në seancën e Kuvendit

Njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim me konstatim që emrat e anëtarëve të propozohen në mbledhjen e Kuvendit.

5. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc

z.Fatmir Gashi, Kryesues, po ashtu në këtë pike kemi të bëjmë me ngritjen e një Komisioni i cili do të merret me ndarjen e shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, nëse nuk keni diçka për të shtuar e hedh në votim që ti rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe emrat të jepen gjatë seancës së nesërme, nëse keni diçka për të shtuar urdhëroni.

Njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim me konstatim që emrat e anëtarëve të propozohen në mbledhjen e Kuvendit.

6. Propozim Plani i Veprimit për transparencë për vitin 2018

z.Fitim Haziri, theksoi, sigurisht që rreth kësaj pike ne do të diskutojmë edhe nesër në Kuvend, por gjatë analizës që i kemi bërë këtij dokumenti kemi parë të udhës që të fusim edhe gjëra tjera në këtë plan në mënyrë që të jemi më transparent, shembull, t’jua mundësojmë mediave lokale transmetimin live në kohë reale të seancave të Kuvendit, përkatësisht t’i ndihmojmë tani TV Llapit, që tani e kemi dhe është mirë që e kemi një televizion lokal.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, pikërisht për shkak të transparencës mendoj se ndoshta do të ishte mirë që mediat lokale, në rastin konkret që u përmend TV Llapi, t’i përcjellë seancat drejtpërdrejtë se çka po thotë pozita e çka opozita, se sa të shkojnë në montazh dhe të bëhen të njëanshëm, kështu që shumë më mirë do të ishte të jetë e gjithanshme çka do që flitet mirë keq, çka pozita e çka opozita. Edhe ashtu televizioni i cekur o i përcjellë seancat dhe po bëjnë raporte, por shumë më transparente është nëse seancat transmetohen në plotni, pa dallime rreth diskutimeve se çka tha ajo parti çka tjetra, se sa të shkojnë me montazhe. E them këtë duke u mbështetur edhe nga praktika ime si gazetarë që kam. Vlen të përmendet se ka raste kur ligji e lejon që ndonjë seancë për shkaqe të ndryshme mund të jetë e mbyllur për publikun.

z.Fitim Haziri, theksoi, shumë Komuna në Kosovë i transmetojnë seancat në kohë reale siç është Prizreni ku është TV Besa, në Mitrovicë është TV Mitrovica e të tjera, andaj përse të mos ndodh një gjë e tillë edhe tek ne në Komunën e Podujevës.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSh, theksoi, sa i përket kësaj që po diskutohet, të jemi të qartë se nuk mundën vetëm ashtu të caktohen medime për të transmetuar seancat e Kuvendit në kohë reale sepse janë disa procedura dhe është konkurrenca ajo që e përcakton një gjë të tillë, pastaj nënshkruhen marrëveshje dhe gjëra tjera, e jo në këtë mënyrë siç po kërkohet

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, gjithçka çka është në harmoni me ligjin dhe që zbatohen procedurat përkatëse unë në parim i mbështes, por jo forma të tilla siç po kërkohet këtu që vetëm ashtu të caktohet një televizion. Gjithashtu nuk do të ishte mirë televizionet të jenë të njëanshme me raporte nga seancat e Kuvendit, por të jenë të paanshme dhe transparente sa më shumë që të jetë e mundur.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, në lidhje me transparencën unë mendoj, dhe të mbetet si propozim që tek çështja e debateve me qytetarë, qytetarët po jenë shumë të informuar për shkak se në facebook apo në ueb faqe lajmërimet dalin vonë dhe në ato vende ku disa nuk kanë qasje në internet nuk ka informim, kërkesa ime është që ne të marrim vendim që në lokacione më shumë të frekuentuara siç janë Lluzhani, Kërpimehu etj, lajmërimet të qiten në formë fizike me qëllim që sa më shumë qytetarë të jenë të informuar. Këtë e them duke pasur një praktik ku në mandatin e

kaluar në debate kanë shkuar po thuajse vetëm pozita, e mos të flasim për qytetarë të cilët shumë pak kanë marrë pjesë.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, çështja të cilën e potencoj parafolësja duhet pasur parasysh se për një gjë të tillë ka edhe kosto pavarësisht sa mund të jetë ajo duhet të caktohet.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë propozim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim.

7. Përfaqësimi i Komunës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me përfaqësimin e Komunës në Asociacionin e Komunave të Republikës së Kosovës, përkatësisht me zgjedhjen e anëtarëve të cilët do ta përfaqësojnë Komunën e Podujevës në këtë Organizatë. Sa për sqarim rreth përbërjes, Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit shkojnë me automatizëm sipas pozitës, kurse duhet zgjedhur edhe tre anëtarë nga radhët e tri subjekteve më të mëdha në Kuvendin e Komunës. Paraprakisht nga konsultat që kemi pas me shefat e Grupeve të këshilltarëve, nga LDK është propozuar z.Avni Fetahu, nga Grupi i LVV-së është propozuar z.Florent Hasani dhe nga Grupi i PDK-së është propozuar z.Rafet Llapashtica, andaj e hedh në votim këtë përbërje që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim, që Komuna e Podujevës të përfaqësohet në AKK, me përbërjen si vijon:

- 1.Agim Veliu, Kryetar i Komunës*
- 2.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës*
- 3.Avni Fetahu, këshilltar i Kuvendit të Komunës*
- 4.Florent Hasani, këshilltar i Kuvendit të Komunës*
- 5.Rafet Llapashtica, këshilltar i Kuvendit të Komunës*

8. Themelimi dhe përbërja e Komitetit për Komunitete - Rishqyrtimi sipas rekomandimit të MAPL-së

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, jeni në dijeni se në mbledhjen e kaluar kemi miratuar themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, mirëpo në procedurën e shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë së këtij akti, Ministria përkatëse ka vlerësuar se ky akt nuk është në harmoni me legjislacionin për shkak se nuk është respektuar përfaqësimi gjinor 50% për të dy gjinitë, andaj ka rekomanduar që i njëjti të harmonizohet sa i përket këtij aspekti. Unë i kam ftuar përfaqësuesit e Komuniteteve jo shumicë dhe kemi biseduar për këtë çështje, ku nga ai takim z.Xhafer Ademi vullnetarisht është tërheq nga kjo përbërje dhe njëkohësisht është propozuar znj.Albina Avdiu në vend të tij.

z.Fitim Haziri, theksoi, kur jemi te ky Komitet, jam në dijeni se z.Patriot Rudari ka bërë ankesë apo kërkesë për sqarime shtesë në Ministri rreth përfaqësimit në Komitete, përkatësisht ka kërkuar përfaqësim ngase siç thotë këshilltari nga radhët e Partisë së Drejtësisë është i përfaqësuar.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, jam në dijeni se këshilltari z.Patriot Rudari ka dërguar shkresë në Ministri për interpretim ligjor rreth përfaqësimit në Komitete, i njëjti ka marrë përgjigjen adekuate nga Ministria. Vendimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politik dhe Financa është kthyer në harmoni me ligjin dhe i njëjti tani veç është duke prodhuar efekt juridik

Njëzëri Kuvendit i rekomandohet për rishqyrtim dhe miratim me konstatim që me qëllim të përfaqësimit të barabartë gjinor, znj.Albina Avdiu propozohet në vend të z.Xhafer Ademit.

9. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit - parcelave për ndërtimin e fushës sintetike të futbollit

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, rreth këtij propozim vendimi ne veç diskutuam në fillim të kësaj mbledhje ku u jepen sqarime dhe shpjegime të nevojshme, andaj nëse nuk keni diçka për të shtuar unë e hedh në votim që t'i rekomandojmë Kuvendit për përfshirje në rend të ditës për mbledhjen që do të mbahet nesër.

Njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim, me rekomandim që Drejtoritë kompetente të zhvillojnë të gjitha procedurat përkatëse dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme në funksion të realizimit të projektit.

Mbledhja përfundoi në orën 14.45

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-060/04-0026791/18
Podujevë,
27 mars 2018**

**Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi**